



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 22 Datë 15. 10. 2007
PËR

**NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË FONDEVE BRENDË
LIMITIT VJETOR PËR KLUBIN E FUTBOLLIT "SKËNDERBEU"**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, « PËR NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË FONDEVE BRENDË LIMITIT VJETOR PËR KLUBIN E FUTBOLLIT "SKËNDERBEU", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007" mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e zërave në shpenzimet operative të Klubit të Futbollit "Skënderbeu", si më poshtë:

Zërat	Plani i vitit 2007 sipas buxhetit	Ndryshimi		Plani i rishikuar
		Shtesa +	Pakesime -	
Materiale sportive	700 000		- 700 000	-----
Detyrime financiare të F.SH.F.	1 000 000		- 500 000	500 000
Dieta	5 000 000	+ 1 160 000		6 160 000
Sigurimet shoqërore	574 000	+ 40 000		614 000
TOTALI	7 274 000	+ 1 200 000	-1 200 000	7 274 000

2. Fondi për rritjen e sigurimeve shoqëore do të përballohet nga fondi i planifikuar i shpenzimeve operative për vitin 2007 (materiale sportive) me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00	08140 05	Art 6020000	- 40.000 lekë
------------------	-----------	-----------------	--------------------	----------------------

Shtohet	00	08140 05	Art 6010000	+40.000 lekë
----------------	-----------	-----------------	--------------------	---------------------

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës në Bashki dhe Klubi i Futbollit "Skënderbeu".

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE

Raimonda NASE